



Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut Drejtoria për Statistikë

Shkup, 26 shkurt 2021

Njoftim për shtyp

Zhvillime më të rëndësishme në bilancin e pagesave¹ në tremujorin e katërt të vitit 2020

Në tremujorin e katërt të vitit 2020, transaksionet rrjedhëse me jorezidentë shënuan një deficit prej 72,4 milionë eurosh, kryesisht si rezultat i deficitit të tregtisë së mallrave. Transaksionet financiare me jorezidentë regjistruan hyrje neto nga huatë, kreditë tregtare dhe investimet direkte, dhe dalje neto bazuar në portfolio investime dhe valuta dhe depozita.

Komponentët bazë të bilancit të pagesave në Republikën e Maqedonisë së Veriut (në milionë euro)

	тековна година					претходна година					квартална промена		годишна промена		збирна промена	
	Кв.1 2020	Кв.2 2020	Кв.3 2020	Кв.4 2020	Кв.1-Кв.4.2020	Кв.1 2019	Кв.2 2019	Кв.3 2019	Кв.4 2019	Кв.1-Кв.4.2019	милиони евра	%	милиони евра	%	милиони евра	%
Тековна сметка	-156.1	-91.9	-52.7	-72.4	-373.0	-175.0	-65.6	162.2	-293.9	-372.3	-19.7	37.5	221.5	-75.4	-0.7	0.2
Стоки	-546.3	-352.4	-403.5	-506.6	-1,808.8	-475.1	-443.5	-436.3	-614.7	-1,969.6	-103.2	25.6	108.1	-17.6	160.8	-8.2
Услуги	164.8	105.0	83.1	78.9	431.8	102.0	96.8	174.5	-23.5	349.8	-4.2	-5.1	102.4	...	82.0	23.4
Примарен доход	-100.4	-99.1	-106.0	-107.0	-412.4	-129.9	-127.7	-130.2	-131.9	-519.6	-1.0	1.0	24.9	-18.9	107.2	-20.6
Секундарен доход	325.8	254.6	373.7	462.3	1,416.4	328.0	408.8	554.1	476.2	1,767.1	88.6	23.7	-13.9	-2.9	-350.7	-19.8
Капитална сметка	0.3	4.3	1.1	3.6	9.3	0.6	0.1	5.9	1.6	8.2	2.5		2.0		1.1	
Финансиска сметка	-170.6	-70.9	-37.7	-54.0	-333.3	-176.1	-51.8	188.3	-265.6	-305.2	-16.2		211.6		-28.1	
Директни инвестиции	-135.9	6.7	7.8	-84.3	-205.7	-59.3	-29.2	-82.3	-192.5	-363.3	-92.1		108.2		157.6	
Нето-стекување средства	106.1	-12.8	47.2	-271.9	-131.3	177.6	108.5	58.3	-219.5	124.9	-319.1		-52.4		-256.2	
Сопственички капитал	5.3	6.6	6.5	6.7	25.1	1.8	5.7	12.9	9.2	29.6	0.1		-2.6		-4.5	
Реинвестирање на добивка	3.2	2.5	2.4	2.1	10.2	2.2	2.2	2.2	2.2	8.9	-0.2		-0.1		1.3	
Должнички инструменти	97.6	-21.9	38.3	-280.7	-166.6	173.5	100.6	43.2	-231.0	86.4	-319.0		-49.7		-253.0	
Нето-создавање обврски	242.0	-19.5	39.4	-187.5	74.3	236.8	137.7	140.6	-27.0	488.2	-227.0		-160.6		-413.8	
Сопственички капитал	20.6	48.3	8.3	19.5	96.7	79.1	45.7	36.4	59.8	221.0	11.2		-40.3		-124.3	
Реинвестирање на добивка	86.3	28.5	-30.2	-69.9	14.8	43.9	43.9	43.9	43.9	175.7	-39.7		-113.8		-161.0	
Должнички инструменти	135.1	-96.4	61.3	-137.2	-37.1	113.8	48.1	60.3	-130.7	91.5	-198.5		-6.5		-128.6	
Портфолио-инвестиции	31.6	-632.5	77.5	239.5	-283.8	22.3	19.9	72.7	36.3	151.2	162.0		203.3		-435.0	
Валуты и депозити	71.8	130.5	175.6	111.4	489.4	35.0	-30.6	98.5	-29.3	73.6	-64.2		140.7		415.8	
Заеми	113.0	-166.7	-83.0	-132.8	-269.4	-16.9	-25.2	-54.9	-128.1	-225.2	-49.8		-4.7		-44.3	
Трговски кредити	-1.9	-13.2	-61.2	-100.3	-176.6	-153.2	-35.7	32.3	-160.8	-317.3	-39.1		60.4		140.7	
Девизни резерви	-249.3	604.0	-153.8	-86.3	114.6	-5.6	49.4	174.4	156.4	374.6	67.5		-242.6		-260.0	

...* процентуалната промена е над 100

** Сопственички капитал, освен реинвестирањето на добивката

Shënim: Në llogarinë financiare shenja (-) tregon hyrjet neto nga vendet e huaja. Tek rezervat valutore shenja (+) tregon rritje, ndërsa shenja (-) tregon zvogëlim të rezervave valutore. Ndryshimet e gñimeve dhe diferencat në kursin e këmbimit janë përjashtuar nga të dhënat për rezervat valutore.

Burimi: BPRMV.

¹ Bilanci i pagesave është një raport statistikor që përmbledh sistematikisht të gjitha transaksionet ekonomike të Republikës së Maqedonisë së Veriut me vendet e huaja për një periudhë të caktuar kohore, gjegjësisht i përmbledh transaksionet rrjedhëse, kapitale dhe financiare ndërmjet rezidentëve dhe jorezidentëve.




Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut Drejtoria për Statistikë

Llogaria rrjedhëse

Në tremujorin e katërt të vitit 2020, transaksionet rrjedhëse me jorezidentë regjistruan deficite në tregtinë e mallrave dhe në të ardhurat parësore (506,6 dhe 107 milionë euro, përkatësisht), të cilat tejkaluan prurjet në të ardhurat dytësore dhe shkëmbimin e shërbimeve (462,3 dhe 78,9 milionë euro, përkatësisht).

Në bazë tremujore, deficitin në llogarinë rrjedhëse u rrit për 19,7 milionë euro. Ndryshimi i këtillë është kryesisht si rezultat i deficitit të rritur në tregtinë e mallrave (për 103,2 milionë euro), dhe në masë më të vogël nga suficiti i reduktuar në shkëmbimin e shërbimeve (për 4,2 milionë euro), në kushte të hyrjeve të rritura neto në të ardhurat dytësore (për 88,6 milionë euro). Deficitin e rritur në tregtinë e mallrave prej 103,2 milionë eurosh del nga rritja më e madhe e importit në raport me rritjen e eksportit të mallrave (për 11,4 dhe 7,2%, përkatësisht).

Krahasuar me tremujorin e njëjtë të vitit të kaluar, saldoja e llogarisë rrjedhëse është përmirësuar për 221,5 milionë euro. Sipas kontributit të komponentëve, ndryshimi vjetor shpjegohet me deficitin e reduktuar në tregtinë e mallrave (108,1 milionë euro), saldon e përmirësuar në shkëmbimin e shërbimeve (për 102,4 milionë euro) dhe deficitin e reduktuar në të ardhurat parësore (për 24,9 milionë euro). Përkundër kësaj, arritje më të dobëta, gjegjësisht rënie të hyrjeve neto janë regjistruar në të ardhurat dytësore (për 13,9 milionë euro).



Burimi: BPRMV.

Në vitin 2020, deficitin e llogarisë rrjedhëse arriti në 373 milionë euro, që është thajse në nivel të pandryshuar krahasuar me vitin 2019. Sipas komponentëve, arritje më të dobëta u regjistruan në saldon e të ardhurave dytësore (hyrje të reduktuara neto për 350,7 milionë euro), ndërsa në të gjithë kategoritë tjera vërehet përmirësim. Në tregtinë e mallrave është regjistruar një deficit i reduktuar për 160,8 milionë euro, deficitin në të ardhurat parësore është më i ulët për 107,2



Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut Drejtoria për Statistikë

milionë euro, ndërsa suficiti në shkëmbimin e shërbimeve regjistroi një përmirësim prej 82 milionë eurosh.

Llogaria financiare

Transaksionet financiare me jorezidentët, në tremujorin e katërt të vitit 2020 shënuan hyrje neto prej 54 milionë eurosh. Analizuar sipas kategorive, hyrje neto shënojnë huatë (132,8 milionë euro), kreditë tregtare (100,3 milionë euro) dhe investimet direkte (84,3 milionë euro), ndërsa dalje neto janë vërejtur në portfolio investime (239,5 milionë euro) dhe valuta dhe depozita (111,4 milionë euro).

Në tremujorin e katërt, investimet direkte shënuan hyrje neto prej 84,3 milionë eurosh. Analizuar sipas komponentëve, arritjet e këtilla janë rezultat nga hyrjet neto në huatë ndërkompani (143,5 milionë euro) dhe në kapital (12,8 milionë euro), me dalje neto në fitimet e riinvestuara (72 milionë euro). Në vitin 2020, në bazë të investimeve direkte u realizuan hyrje neto prej 205,7 milionë euro, që është një ulje për 157,6 milionë eurosh krahasuar me vitin 2019. Në vitin 2020, neto hyrje janë regjistruar në të gjithë komponentët e investimeve direkte: huatë ndërkompani (129,5 milionë euro), kapital (71,6 milionë euro) dhe fitimet e riinvestuara (4,5 milionë euro).

Në tremujorin e katërt të vitit 2020, detyrimet në bazë të investimeve direkte² janë reduktuar për 187,5 milionë euro, si rezultat i detyrimeve të zvogëluara në bazë të huave ndërkompani (137,2 milionë euro) dhe fitimit të riinvestuar (69,9 milionë euro), pjesërisht i neutralizuar me detyrimet e rritura të kapitali (19,5 milionë euro). Ulja e fitimit të riinvestuar është rezultat i shumës relativisht të lartë të dividendit së paguar në tremujorin e katërt të vitit në shumë prej 159,9 milionë eurosh. Kolektivisht në vitin 2020, detyrimet ndaj investitorëve direktë u rritën për 74,3 milionë euro, që është për 413,8 milionë euro më pak krahasuar me vitin 2019 dhe është rezultat i arritjeve në të tre komponentët e investimeve direkte.

Në tremujorin e katërt të këtij viti, aktivet në bazë të investimeve direkte u zvogëluar për 271,9 milionë euro, si rezultat të arkëtueshmeve të reduktuar në bazë të instrumenteve të borxhit (280,7 milionë euro), me një rritje të pretendimeve në bazë të kapitalit (6,7 milionë euro) dhe fitimit të riinvestuar (2,1 milionë euro). Për të përmbledhur, për vitin 2020, aktivet janë zvogëluar për 131,1 milionë euro, përkundër rritjes (prej 124,9 milionë eurosh) në vitin 2019. Ndryshimi kumulativ (prej 256,2 milionë eurosh), në masë të madhe del nga të arkëtueshmet e zvogëluara në bazë të instrumenteve të borxhit.

Në tremujorin e katërt të vitit, detyrimet neto në bazë të portfolio investimeve janë zvogëluar për 239,5 milionë euro, që në masë të madhe del nga maturimi i detyrimeve pas Euro-obligacionit të

² Paraqiten investime direkte në varësi të faktit nëse transaksionet financiare krijojnë detyrim ndaj ose të arkëtueshme (aktive) nga vendet e huaja.





Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut Drejtoria për Statistikë

katërt në muajin nëntor, dhe në masë më të vogël nga blerja e Euro-obligacionit nga emetimet paraprake, nga ana e rezidentëve në tregjet e huaja financiare.

Hyrjet neto në bazë të huave prej 132,8 milionë eurosh, në tremujorin e katërt të vitit 2020, në masë të madhe dalin nga hyrjet neto në sektorin „qeveri“ (96,6 milionë euro), dhe në masë më të vogël edhe nga hyrjet neto në sektorët e tjerë³ (48,4 milionë euro), përkundër detyrimeve të zvogëluara neto të sektorit „institucione depozituese“ (12 milionë euro). Për të përmbledhur për vitin 2020, hyrjet neto në bazë të huave janë 269,4 milionë euro, me hyrje të konsiderueshme në sektorin „qeveri“ (115,7 milionë euro), sektorët tjerë (113,3 milionë euro) dhe sektori „institucione depozituese“ (42,2 milionë euro).

Për vitin 2020, hyrjet neto nga portfolio investimet (283,8 milionë euro), huatë (269,4 milionë euro), investimet direkte (205,7 milionë euro) dhe kreditë tregtare (176,6 milionë euro) i tejkaluan daljet neto në bazë të valutave dhe depozitave (489,4 milionë euro), gjë që mundësoi financim të tërësishëm të deficitit të llogarisë rrjedhëse prej 373 milionë eurosh dhe rritje të rezervave valutore prej 114,6 milionë euro.



Burimi: BPRMV.

Rishikim i të dhënave

Të dhënat për bilancin e pagesave në këtë njoftim përmbajnë rishikim të rregullt të të dhënave për periudhën janar-shtator të vitit 2020 për shkak të përmirësimit të cilësisë së tyre. Me rishikimin e të dhënave, deficitin në llogarinë rrjedhëse është rritur për 24 milionë euro, ndërsa hyrjet neto në llogarinë kapitale janë rritur për 3 milionë euro.

³ Sektorët tjerë përfshijnë: institucione tjera financiare, ndërmarrje jofinanciare, amvisëri dhe institucione jofitimprurëse të cilat i shërbejnë amvisëritë.



Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut Drejtoria për Statistikë

Në llogarinë financiare rishikimi ka të bëjë me rritjen e hyrjeve neto në investimet direkte për 24,7 milionë euro dhe në kreditë tregtare për 7 milionë euro, përkundër zvogëlimit të hyrjeve neto tek huatë për 1,6 milionë euro.

Rishikimi i të dhënave çoi në zvogëlim të gabimeve dhe lëshimeve për periudhën janar-shtator të vitit 2020 për 10 milionë euro.

Informacione shoqëruese

Të dhënat e serive kohore: të dhëna vjetore, tremujore dhe mujore për bilancin e pagesave
http://www.nbrm.mk/platen_bilans.nspix

Shpjegime metodologjike: http://www.nbrm.mk/platen_bilans.nspix

Publikimet e ardhshme: Kalendari i publikimit të të dhënave
http://www.nbrm.mk/kalendar_na_objavuvanje_na_podatoci.nspix

Bilanci tremujor i pagesave: 31 maj i vitit 2021 (mesatare referuese me marsin e vitit 2021).

Për pyetje gazetarësh, ju lutemi kontaktoni me personat e Kabinetit të Guvernatorit.

Për informacione më të hollësishme lidhur me të dhënat e publikuara statistikore, na kontaktoni në: contact.statistika@nbrm.mk ose në numrin e telefonit 02 3215 181 lokali 103 (ose 110/108).